



BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Në bazë të nenit 48 paragrafit 1 pika 3 nga Ligji për Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/10, 123/12, 43/14, 153/15 и 6/16), nenit 40 paragrafit 3 nga Ligji për operacione valutore („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 34/01, 49/01, 103/01, 51/03, 81/08, 24/11, 135/11, 188/13, 97/15, 153/15 и 23/16) dhe pikës 9 nga Vendimi për mënyrën dhe procedurën e raportimit për transaksione me jorezidentë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 87/14), Guvernatori i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë miratoi

UDHËZIM

për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit për mënyrën e raportimit për gjendjen dhe ndryshimet e kapitalit dhe të huave ndërmjet kompanive të lidhura me kapital në bazë të investimeve jashtë vendit

1. Në Udhëzimi për mënyrën e raportimit për gjendjen dhe ndryshimet e kapitalit dhe huave ndërmjet kompanive të lidhura me kapital në bazë të investimeve jashtë vendit („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 108/14 dhe 200/16), në pikën 2, pas paragrafit 14 shtohen dy paragrafë të ri me këtë përmbajtje:

„**Aksionet** janë letra me vlerë me të cilat investitori përfiton të drejtën e pronësisë të një pjese të ndërmarrjes - emetuesit të letrave me vlerë, proporcionalisht me numrin e letrave me vlerë të cilat i posedon në totalin e kapitalit dhe i cili mund ti japi të drejtë vote, të drejtë për dividendë dhe të drejtë të një pjese tjetër nga vlera e ndërmarrjes.

„**Aksione dhe stoqe** në fondin për investim janë stoqet ose aksionet e emetuar nga fondet për investim.”

2. Në pikën 3 shtohet paragraf i ri 1 me këtë përmbajtje:

„Investitorët janë të obliguar të njoftojnë Bankën Popullore në pajtim me aktin nënligjori i cili i rregullon mënyrën dhe procedurën për raportim të transaksioneve me jorezidentë, konkretisht për gjendjen dhe ndryshimet e kapitalit dhe huave ndërmjet kompanive të lidhura me kapital në bazë të investimeve jashtë vendit. Me përjashtim, për investimet jashtë vendit në ndërmarrje me formë organizative "shoqëri aksionare" dhe me pjesëmarrje nën 10% në aksionet e emetuara, si dhe për investimet në aksione dhe stoqe në fondin për investime, investitorët nuk kanë obligim të raportojnë në pajtim me këtë udhëzim”.

Paragrafët 1, 2, 3, 4 dhe 5 bëhen paragrafë 2, 3, 4, 5, 6.

3. Ky udhëzim hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë", dhe do të zbatohet nga data 1 janar 2018.

U nr. 38036
13.12.2017
Shkup

Guvernator
Dimitar Bogov